


Raport nga

MBIKËQYRJA E PUNËS SË KËSHILLIT GJYQËSOR

janar - qershor 2022



Проектот е финансиран
од Европската Унија



Институт за човекови права

Titulli:

RAPORT NGA MBIKËQYRJA E PUNËS SË KËSHILLIT GJYQËSOR
Për periudhën Janar - Qershor 2022

Botues:

Shoqata e qytetarëve Instituti për të drejtat e njeriut Shkup

Shkup, gusht 2022

Ky publikim është prodhuar me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian.
Përmbajtja e tij në asnjë mënyrë nuk pasqyron pikëpamjet e Bashkimit Evropian.

HYRJE



janar deri në
qershor 2022

Instituti për të Drejtat e Njeriut, duke marrë pjesë në të gjitha seancat e hapura, monitoron rregullisht punën e Këshillit Gjyqësor. Qëllimi i këtij aktiviteti është që Instituti i të Drejtave të Njeriut, nëpërmjet monitorimit objektiv të punës së tij, të evidentojë problemet dhe ecurinë në punën, si dhe të kontribuojë, me konkluzione dhe rekomandime të bazuara në prova, në përmirësimin e situatës në drejtësi.

Ky raport është i ndarë në tre pjesë kryesore që i referohen **transparencës**, **efektivitetit** dhe **efikasitetit** të Këshillit Gjyqësor.



Për qëllime të këtij raporti janë shfrytëzuar këto burime informacioni: pjesëmarrja në të gjitha seancat e hapura të Këshillit Gjyqësor, raportet për Këshillin Gjyqësor, njoftimet dhe dokumentet e publikuara në faqen e internetit të Këshillit Gjyqësor të RMV-së, raportimet e mediave etj.



TRANSPARENCA E KËSHILLIT GJYQËSOR



mbajtur
15 seanca

Transparenca në shpalljen e seancave tregon vazhdimësi, krahasuar me vitin e kaluar, që do të thotë se njoftime për seancat publikohen me kohë dhe menjëherë pas përfundimit të çdo seance shpallet edhe njoftimi për vendimet e marra.

Respektohet detyrimi ligjor për publikimin e procesverbaleve të mbledhjeve të KGJRMV-së dhe procesverbalet, të cilat janë të detajuara, publikohen pas miratimit të tyre.

Megjithatë, vërehet miratimi më i ngadaltë i procesverbalit, ndryshe nga më para. Ndoshta një nga arsyet për këtë është se disa nga anëtarët e Këshillit kanë vërejtje për përmbajtjen e tyre, pra që disa prej anëtarëve kërkojnë që diskutimet e tyre të futen në mënyrë të saktë dhe të mos parafrazohen. Për këtë arsye, vërehet se ato nuk publikohen në vazhdimësi, duke pasur parasysh se procesverbali për t'u publikuar duhet të miratohet në mbledhje.

Nuk funksionon sistemi elektronik i regjistrimit të zërit dhe votimit. Anëtarët votojnë publikisht, duke ngritur duart dhe nëse njëri prej tyre nuk është i pranishëm në mbledhje, atëherë mbledhja monitorohet dhe votohet përmes aplikacionit Viber, i cili është krijuar si praktikë gjatë pandemisë së shkaktuar nga Covid-19. Seancat regjistrohen në diktafon dhe procesverbali mbahet nga shërbimi.

Është respektuar obligimi ligjor për miratimin e Raportit Vjetor të Punës së KGJRMV-së.¹ Menjëherë pas miratimit, raporti u publikua në uebfaqen dhe iu dorëzua Kuvendit.

Raporti vjetor përmban detaje dhe të dhëna për gjyqtarët e zgjedhur dhe të shkarkuar, mbi aktualitetin e gjykatave dhe të ngjashme. **Është detyrim ligjor që raporti të përmbajë të dhëna për përmbushjen e Programit Vjetor të Punës**, megjithatë, ndërsa aktivitetet dhe objektivat e programit renditen dhe jepet shpjegimi për to, kjo pjesë **nuk jep një pasqyrim të plotë të përmbushjes së Programit Vjetor** dhe aktivitetëve të detajuara për çdo qëllim. Në të njëjtën kohë, raporti i punës së KGJRMV-së për vitin 2021 ende nuk është miratuar nga Kuvendi.

Mund të vërehet një numër më i vogël i seancave të mbajtura në nivel mujor, por të njëjtat janë me axhenda dhe pika më të gjera për shqyrtim. Një seancë është rezervuar gjithmonë për vendosjen e kërkesave të qytetarëve dhe personave juridikë, që është edhe obligim ligjor. Është një praktikë e zakonshme që në javën e fundit të muajit të shqyrtohen dhe të vendoset për kërkesat e dorëzuara.

Por për këtë mënyrë të punës ka reagime nga disa anëtarë të Këshillit të cilët reagojnë se ka nevojë për më shumë seanca për të diskutuar pika të rëndësishme që meritojnë vëmendje dhe shkaktojnë dilema te anëtarët. Ata theksojnë se nuk mjafton të debatosh për to në mbledhjen e stafit. Këshilli Gjyqësor, si organ kolektiv, vendos në seanca publike, kështu që në përputhje me këtë, është e nevojshme të diskutohet në seancë për të miratuar qëndrime të harmonizuara, e jo të diskutohen vetëm pikat për të cilat me ligj duhet të vendosen nga ana e KGJRMV.

Ndër të tjera është kërkuar disa herë shqyrtimi i kërkesave të gjyqtarëve në lidhje me statusin e tyre pas hyrjes në fuqi të ndryshimeve në ligjin për marrëdhëniet e punës, për të arritur në konkluzione, por këto kërkesa më parë nuk ishin vënë në rend dite deri më ditën kur KGJRMV duhej të merrte një vendim.

Sa i përket vetë mënyrës së zhvillimit të seancave dhe angazhimit të anëtarëve të Këshillit Gjyqësor, konstatohet një aktivitet i vazhdueshëm i shtuar i **anëtarëve individualë të cilët marrin pjesë në punën e Këshillit Gjyqësor duke dhënë mendime, vërejtje dhe propozime**. Debati mbi pikat e rendit të ditës zgjat më shumë se zakonisht me pjesëmarrjen konstruktive të disa anëtarëve, të cilët shprehin mendimin e tyre për një çështje specifike përmes përgjigjeve dhe argumenteve. Mendimet kontradiktore të anëtarëve që tregojnë interpretime të ndryshme të aspekteve procedurale janë të zakonshme, por ndonjëherë këto interpretime individuale krijojnë vështirësi në zhvillimin e seancave. **Këto interpretime të ndryshme tregojnë për konstruktivitetin dhe angazhimin e vazhdueshëm të anëtarëve, të cilat janë thelbësore në zhvillimin e një debati dhe marrjen e vendimeve të shëndosha.**

Përkundër faktit se **Ministri i Drejtësisë dhe Kryetari i Gjykatës së Lartë të RMV (GJLRMV) janë anëtarë ex officio të Këshillit**, vërehet prania e tyre shumë e rrallë, ose se aspak nuk janë të pranishëm në seancat. Edhe pse ministri i Drejtësisë prej vitesh nuk merr pjesë në seanca, pjesëmarrja e tij në seancat individuale do të ishte domethënëse, aq më tepër që ministri i drejtësisë shfaqet si propozues i ligjeve të rëndësishme në fushën e drejtësisë dhe për këtë arsye bashkëjetesa e tij me Këshillin gjyqësor është e domosdoshme për bashkëpunim të pandërprerë në zbatimin e reformave gjyqësore. **Kryetarja e GJLRMV-së e arsyeton mungesën e saj me dorëzimin e vonë të ftesës (me rendin e ditës) dhe materialeve për seancën. Mungesa e saj është kryesisht për arsye të justifikuara, por kur merr pjesë në seancat, ajo kontribuon në punën e Këshillit Gjyqësor.** Sipas rregullores ligjore, kryetarja

1 Neni 100 i Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut ("Gazeta Zyrtare e RMV" nr. 102/2019)

e GJLRMV-së nuk ka të drejtë vote në seanca, por prania e saj do të thotë mundësi për të diskutuar çështje të rëndësishme dhe shkëmbim përvojash që ndikojnë në punën e Këshillit Gjyqësor dhe Gjykatës së Lartë, por edhe gjyqësorit në përgjithësi. Pikërisht për këtë arsye edhe synimi i ligjvënësit është të lidhë këto dy institucione të rëndësishme gjyqësore me situatën aktuale në gjyqësor duke respektuar parimet e pavarësisë, paanshmërisë, publicitetit dhe transparencës.

Analiza e përmbajtjes së njoftimeve dhe deklaratave të Këshillit Gjyqësor në media:

Duke ndjekur faqen e internetit të Këshillit Gjyqësor, mund të konstatohet një ndryshim pozitiv në mënyrën dhe përmbajtjen e njoftimeve të publikuara në të. Vihet re **përshkrim më i detajuar i pikave të rendit të ditës** që janë diskutuar në seanca, si dhe **raporte më të detajuara për takimet që kanë pasur me ambasadorë dhe përfaqësues të institucioneve dhe organizatave ndërkombëtare**. Kjo, para së gjithash, për shkak të forcimit të personelit të departamentit për bashkëpunim me publikun me një punonjës të ri, i cili me profesion është gazetar.



HAPJA NDAJ PUBLIKUT DHE MEDIAS

Ndryshe nga periudha para pandemisë së shkaktuar nga koronavirusi, **është vërejtur rënie e interesit dhe rënie e prezencës së mediave në seancat e hapura**. Së fundi në media nuk ka informacion për punën e KGJRMV-së dhe kryetarja nuk thlret konferenca për shtyp dhe takime me media kur ka çështje të rëndësishme që janë në kompetencë të organit dhe që janë në interes të publikut. Deklaratat ose intervistat e kryetares, për ngjarjet të caktuara aktuale, mund të regjistrohen. Gjatë kësaj periudhe është mbajtur vetëm një konferencë për media, në të cilën është prezantuar raporti për punën e KGJRMV për vitin 2021.

EFEKTIVITETI DHE EFIKASITETIT I KËSHILLIT GJYQËSOR



ZGJEDHJA E NJË ANËTARI TË KËSHILLIT GJYQËSOR NGA RADHËT E GJYQTARËVE

Në gjysmën e parë të vitit 2022 nuk ka pasur zgjedhje të anëtarit të Këshillit Gjyqësor nga radhët e gjyqtarëve. Me daljen në pension të tre anëtarëve të Këshillit, të cilët vijnë nga mesi i gjyqtarëve, përkatësisht Kire Zdravev, Zoran Teofilovski dhe Gordana Spireska, në përputhje me ndryshimet e reja të Ligjit për marrëdhëniet e punës, do të jetë e nevojshme të zgjidhen tre anëtarë të rinj në periudhën e ardhshme.

Pas rekomandimeve të shumta, në Ligjin për KGJRMV², nga viti 2019, për herë të parë u është dhënë mundësia që gjyqtarët të mund të paraqesin drejtpërdrejt kërkesë për fillimin e procedurës për përgjegjësi disiplinore të një anëtari të Këshillit Gjyqësor që ata kanë zgjedhur. Një kërkesë e tillë mund të paraqitet nga të paktën 20 gjyqtarë, ose çdo anëtar i Këshillit Gjyqësor, me të drejtë vote. Ligjvënësi, gjatë hartimit të tekstit të Ligjit për KGJRMV nuk ka paraparë afate në dispozita të caktuara, gjë që lë hapësirë për praktika të mundshme korruptive, ndikim mbi anëtarët e Këshillit Gjyqësor apo shfaqjen e konfliktit të interesit, në kundërshtim me dispozitat ligjore. Të tilla zbrazëtira ligjore gjenden në nenin 32, i cili i referohet largimit të përkohshëm nga ushtrimi i detyrës së anëtarit të Këshillit Gjyqësor, si dhe në nenin 35, për paraqitjen e kërkesës për fillimin e procedimit disiplinor për një anëtar të Këshillit Gjyqësor.

Deri më tani nuk është paraqitur asnjë kërkesë për inicimin e procedurës për përgjegjësi disiplinore të një anëtari të Këshillit Gjyqësor. Është me rëndësi të theksohet se për një anëtar të Këshillit Gjyqësor, përfaqësues i zonës së apelit të Gostivarit, Prokuroria Themelore Publike për ndjekjen e krimit të organizuar dhe korrupsionit ka ngritur padi si i pandehur i parë, së bashku me 6 persona të tjerë, për privatizim të paligjshëm të tokës në Tetovë. Këshilli Gjyqësor, në dhjetor 2019, i hoqi imunitetin gjyqësor, por ndërkohë, pavarësisht se gjykata pranoi akuzën dhe nisi procedurat gjyqësore, Këshilli Gjyqësor nuk nisi procedurë për largimin e tij të përkohshëm nga detyra e anëtarit të Këshillit, i cili do të ishte një hap i mirë për të rikthyer besimin e qytetarëve në një gjyqësor të paanshëm dhe të pavarur. Në ndërkohë, për shkak të plotësimit të kushteve për pension moshe, anëtari i Këshillit për të cilin po zhvillohet procedimi penal është shkarkuar nga detyra e gjyqtarit, por edhe nga detyra e anëtarit të Këshillit Gjyqësor të RMV.

² Nenet 34 dhe 35 i LKGJRMV-së ("Gazeta Zyrtare e RMV" nr. 102/2019).



ZGJEDHJA E GJYQTARËVE DHE E KRYETARËVE TË GJYKATAVE

Gjatë kësaj periudhe raportuese (janar-qershor 2022), Këshilli Gjyqësor i RMV-së ka kryer aktivitetet që rrjedhin nga kompetencat e tij, të cilat kanë të bëjnë me afate të caktuara të përcaktuara në ligj ose në Rregulloren e Punës së KGJRMV-së, por nuk ka bërë zgjedhje, pra avancimin e gjyqtarëve. Karakteristikë për këtë periudhë është **kryerja e aktiviteteve përgatitore për vlerësimin e gjyqtarëve, e cila lidhet drejtpërdrejt me ngritjen e tyre në detyrë**. Gjegjësisht, me Ligjin për KGJRMV, nga viti 2019, për çdo avancim të gjyqtarëve është e nevojshme që të bëhet vlerësimi i tyre dhe atë në përputhje me metodën e re të vlerësimit. Për një kohë të gjatë, KGJRMV hartoi aktet nënligjore (të cilat u asistuan nga ekspertë të jashtëm) lidhur me zbatimin e mënyrës së re të vlerësimit të gjyqtarëve dhe kryetarëve të gjykatave. Për përkujtim, gjatë vitit 2020, janë miratuar **Metodologjia për vlerësimin cilësor të kryetarëve të gjykatave dhe Metodologjia e vlerësimit të punës së gjyqtarit bazuar në përmbushjen e kriterëve cilësorë për punën e gjyqtarit**, ndërsa gjatë vitit 2021 **Metodologjia me tregues për përcaktimin e kompleksitetit të lëndëve dhe Rregullorja për mënyrën e formimit të komisioneve për vlerësimin e punës së gjyqtarëve dhe kryetarëve të gjykatave**. **Më 29 mars 2022, KGJRMV miratoi aktin e fundit të nevojshëm për fillimin e vlerësimit të gjyqtarëve Rregullorja për themelimin dhe funksionimin e Komisioneve të KGJRMV për vlerësimin e rregullt dhe të jashtëzakonshëm**. Bazuar në këtë, në prill të vitit të njëjtë u formuan komisione për inspektimin dhe vlerësimin e gjyqtarëve dhe kryetarëve të gjykatave, për gjykatat themelore dhe të apelit dhe për gjykatën administrative, të cilat përbëheshin nga 5 anëtarë dhe që do të zbatojnë vlerësim të rregullt të të gjithë gjyqtarëve dhe kryetarëve të gjykatave. Në të njëjtën kohë u formuan komisione për vlerësimin e punës së gjyqtarëve dhe kryetarëve të gjykatave, të cilat duhet të bëjnë një vlerësim të jashtëzakonshëm të kandidatëve që aplikuan për ngritje në detyrë, pra për kryetar gjykate. Formimi i komisioneve solli shumë dilema (paqartësi) lidhur me punën e tyre praktike dhe për këtë arsye u organizuan takime me ekspertë, të cilët u përfshinë në procesin e zhvillimit të metodologjive, me qëllim të zbatimit më të lehtë të tyre dhe njëkohësisht për të kryer trajnime të anëtarëve të komisioneve.

Mund të thuhet se KGJRMV i kushtoi një kohë të gjatë aktiviteteve përgatitore për realizimin e vlerësimit të gjyqtarëve dhe kryetarëve të gjykatave, gjë që është e kuptueshme, duke qenë se bëhet fjalë për një proces vlerësimi të ndërlikuar dhe kompleks. Por nga ana tjetër, kjo ndikoi negativisht në avancimin e gjyqtarëve të cilët iu përgjigjën njoftimeve të shpallura më shumë se një vit më parë, për të cilat procedura kishte filluar dhe ende nuk është zbatuar plotësisht. Kjo vonesë në përzgjedhjen e gjyqtarëve në gjykatat më të larta justifikohet me nevojën e kryerjes së një vlerësimi të jashtëzakonshëm të kandidatëve, gjë që paraqet kërkesë ligjore. Megjithatë, nevoja për plotësimin e vendeve vakante të gjyqtarëve në disa gjykata është më se e nevojshme, siç shihet edhe nga vonesa e tyre në disa periudha tremujore. Për këto arsye, aktualisht janë aktive shpalljet për përzgjedhjen e gjyqtarëve, ndër të tjera, në GJLRMV, në Gjykatën e Apelit Shkup dhe në Gjykatën e Apelit Gostivar, ku kanë aplikuar një numër i madh i kandidatëve, interesimi i gjyqtarëve për avancim është i madh, dhe dy gjykata kanë një numër më të madh postesh gjyqësore vakante.

Gjegjësisht, në GJLRMV, sipas sistematizimit, janë 28 pozita gjyqtarësh, por në mënyrë aktive punojnë vetëm 18 gjyqtarë. Në Gjykatën e Apelit në Shkup janë 52 pozita gjyqësore, por janë aktive vetëm 39 gjyqtarë, ndërsa në Gjykatën e Apelit të Gostivarit janë planifikuar 16 pozita gjyqësore dhe në mënyrë aktive punojnë vetëm 11 gjyqtarë.

SHKARKIMI I GJYQTARËVE DHE KRYETARËVE TË GJYKATAVE



Në periudhën deri në qershor 2022, Këshilli Gjyqësor **shkarkoi 2 (dy)** gjyqtarë dhe shqiptoi 1 (një) masë për **shkelje më të rëndë disiplinore**.

Një gjyqtar i GJLRMV-së është shkarkuar për shkak të shkeljeve të bëra si ushtrues i detyrës së kryetarit të Gjykatës Themelore (arsyeja - shpërdorimi i pozitës zyrtare dhe tejkalimi i autorizimit zyrtar duke mos zbatuar dispozitat për shpërndarjen e lëndëve gjyqësore, që do të thotë se ka kryer në mënyrë joprofesionale dhe të pakujdesshme funksionin të ngarkuarit me detyrë Kryetar).

Gjyqtari është shkarkuar nga Gjykata e Apelit në Shtip, për shkak të kryerjes joprofesionale dhe të pakujdesshme të funksionit gjyqësor (arsyeja - mospërfundimi i gjyqarit nga veprimi dhe vendosja në procedurë para Gjykatës së Apelit në Shtip, ku si i autorizuar i paditësit paraqitet një shoqatë avokature ku si avokat punon një person me të cilin gjyqtari ka lidhje familiare).

Është shqiptuar masë për kundërvajtje më të rëndë disiplinore (arsye - veprim dhe pjesëmarrje në vendimmarrje në procedurë para Gjykatës së Apelit Shtip, ku si i autorizuar i paditësit paraqitet një shoqatë avokature ku si avokat punon një person me të cilin gjyqtari ka lidhje familiare).

Është e rëndësishme që në këtë raport të përmendet shkarkimi i gjyqtarëve, gjegjësisht pensionimi i 42 gjyqtarëve për shkak të hyrjes në fuqi të ndryshimeve dhe plotësimeve në Ligjin për Marrëdhëniet e Punës.³ Ndryshimet parashikojnë që të gjithë ata që kanë lidhur kontratë pune dhe që kanë plotësuar kushtet e pensionit me moshë (të paktën 64 vjeç dhe 15 vjet shërbim) nuk do të mund të vazhdojnë punën, pra do të duhet të dalin në pension. Këshilli Gjyqësor, në seancën e mbajtur më 1 korrik 2022, duke zbatuar këtë zgjidhje ligjore, ka nxjerrë në pension 42 gjyqtarë që plotësonin kushtet për pension moshe, të cilët kishin vazhduar mandatin në bazë të mundësisë që ofronte ligji më parë. Ky problem ekziston për një kohë të gjatë. Pritej miratimi i ndryshimeve në Ligjin për ndryshimin e ligjit për marrëdhëniet e punës, me qëllim që të parandalohet pensionimi i një numri të madh të gjyqtarëve dhe në këtë mënyrë të parandalohet një mungesë edhe më e madhe e gjyqtarëve në të gjitha instancat gjyqësore.

Lidhur me këtë çështje, KGJRMV nuk ka diskutuar edhe pse ka pasur dilema dhe kërkesa nga gjyqtarët dhe disa anëtarë të KGJRMV për të diskutuar dhe marrë parasysh të gjitha mundësitë që ofrojnë ligjet përkatëse në rast se nuk miratohen ndryshimet në Ligjin e Punës nga Kuvendi. Për këtë arsye, Këshilli Gjyqësor u gjend në një pozitë të palakmueshme menjëherë pas hyrjes në fuqi të ndryshimeve dhe shtesave në Ligjin për Marrëdhëniet e Punës më 30 qershor 2022, për të diskutuar për vlefshmërinë ligjore të pensionimit të gjyqtarëve që kanë plotësuar kushtet për pension pleqërie sipas ndryshimeve ligjore aktuale. U vunë në dukje një sërë problemesh me daljen në pension të njëkohshëm të një numri të madh gjyqtarësh, përkatësisht caktimi (jo)me kohë i lëndëve, caktimi i ri i gjyqtarëve nëpër këshillat, rifillimi i një numri të madh çështjesh gjyqësore për shkak të ndryshimit të gjyqarit, përdorimi i pushimeve dhe pasasë gjithash mbingarkesa me lëndë të gjyqtarëve të tjerë që do të trashëgojnë lëndët e kolegëve të tyre që do të dalin në pension, në një situatë ku tashmë ka një mungesë të madhe gjyqtarësh në të gjitha shkallët dhe brezi i ardhshëm i kandidatëve nga Akademia e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve Publikë do të përfundojë trajnimin në dhjetor 2022.

Pyetjet që u ngritën më pas në seancën në të cilën u pensionuan 42 gjyqtarët lidheshin me korrelacionin – marrëdhënia e punës kundrejt mandatit të gjyqtarëve, me kolapsin që mund të përballet gjyqësori për shkak të mungesës së një numri të madh gjyqtarësh, por nga ana tjetër, rekomandimi i BE-së për uljen e numrit të gjyqtarëve, në përputhje me standardet evropiane.

Çështja e **pensionimit të gjyqtarëve, anëtarë të KGJRMVmbeti** e diskutueshme. Në këtë seancë nga radhët e gjyqtarëve dolën në pension dy anëtarë të Këshillit Gjyqësor – Kiro Zdravev nga GJLRMV dhe Zoran Teofilovski nga Gjykata e Apelit në Gostivar, por mbetet pyetja se a do të shkarkohen mbi atë bazë nga anëtarët e Këshillit Gjyqësor. Ligjin për KGJRMV nuk përmban dispozitë për një situatë të kështillë dhe në anën tjetër ata janë zgjedhur anëtarë të Këshillit Gjyqësor sepse janë gjyqtarë aktivë. Nga seanca u krijua përshtypja se ata janë shkarkuar vetëm nga posti i gjyqtarit, por jo edhe si anëtarë të KGJRMV. U theksua se Gjykata Kushtetuese nuk i është përgjigjur pozitivisht kësaj dileme, edhe pse është ngritur si çështje nga KGJRMV. **Mirëpo, në pajtim me dispozitat ligjore, anëtar i Këshillit Gjyqësor mund të jetë vetëm gjyqtar aktiv, kështu që konstatohet se mandati i anëtarëve të KGJRMV-së Kire Zdravev, Zoran Teofilovski dhe Gordana Spirevska do të përfundojë në gusht 2022 për shkak të plotësimit të kushteve për pension moshe.**

MONITORIMI I PUNËS SË GJYKATAVE



Monitorimi i punës së gjykatave bëhet nga KGJRMV përmes shqyrtimit dhe vlerësimit të raporteve tremujore dhe vjetore për punën e gjykatave, por edhe nëpërmjet vizitave në gjykata nga komisionet e përbëra nga anëtarë të Këshillit Gjyqësor, që parashihet në Planin e Brendshëm për monitorimin dhe vlerësimin e punës së gjykatave, gjyqtarëve dhe kryetarëve të gjykatave për vitin 2022.

Nga raportet tremujore për punën e gjykatave mund të konstatohet se vazhdon trendi i gjykatave joefikase dhe arsytet për këtë gjendje janë zvogëlimi i numrit të gjyqtarëve, numri i pamjaftueshëm i stafit administrativ dhe rritja e numrit të lëndëve.

Pas vizitave në gjykata, anëtarët e komisionit që kanë kryer vizitën e prezantojnë në seancë raportin e vizitës, duke evidentuar gjetjet më domethënëse që kanë arritur dhe duke propozuar konkluzione për veprime të mëtejshme nëse janë konstatuar mangësi në funksionimin e gjykatës ose të disa gjyqtarëve ose kryetarëve të gjykatave.



VENDIMARRJA PËR PARASHTRESAT E QYTETARËVE DHE PERSONAVE JURIDIKË

Parashtresat e qytetarëve dhe subjekteve juridike që i paraqiten KGJRMV-së, e që kanë të bëjnë me punën e gjyqtarëve dhe kryetarëve të gjykatave, shqyrtohen dhe zgjidhen rregullisht në përputhje me afatet ligjore.

Këshilli Gjyqësor i hedh poshtë si të pabazuara numrin më të madh të peticioneve, duke pasur parasysh se me peticionet qytetarët, pra personat juridikë kërkojnë ndryshimin e vendimit të gjykatës, sepse nuk janë të kënaqur me të. Në shumicën e rasteve, Këshilli Gjyqësor konstaton se procedimi i lëndës bazohet në ankim në gjykatën e shkallës së dytë, kështu që gjykata e shkallës së dytë do t'i vlerësojë pretendimet në peticion si pretendime ankimore?? në procesin e vendimmarrjes, dhe si rrjedhojë nuk ka kompetencë të ndërhyjë në vendime gjyqësore, as t'i ndryshojë ato, duke mos konstatuar arsye për veprim”.

Mirëpo, për shkak të numrit të madh të parashtresave lidhur me mosrespektimin e parimeve të fajësimit të gjyqtarëve, Këshilli Gjyqësor vizitoi dhe inspektoi punën e Gjykatës së Apelit në Shtip. Nga raporti i paraqitur, mund të konstatohen devijime të caktuara për sa i përket respektimit të dispozitave që kanë të bëjnë me shkarkimin e gjyqtarëve, si nga vetë gjyqtarët ashtu edhe nga kryetarët e gjykatave që vendosin për kërkesat për shkarkim. Si pasojë e situatave të tilla, dy gjyqtarë janë shkarkuar nga gjykata, por situata ende nuk është zgjidhur, gjë që tregon nevojën që Këshilli Gjyqësor, brenda kompetencave të tij, të reagojë dhe të veprojë për zgjidhjen e kësaj situatë.

REKOMANDIME

Bazuar në monitorimin e seancave të hapura të Këshillit Gjyqësor, raporteve për Këshillin Gjyqësor, njoftimeve dhe dokumenteve të publikuara në faqen e Këshillit Gjyqësor të RMV, raportimeve të mediave, mund të rekomandohet:



Këshilli Gjyqësor duhet të analizojë me kujdes zgjedhjen e strategjive dhe veprimeve, në mënyrë që të sigurojë një gjyqësor që do të jetë i pavarur, i paanshëm dhe që do të punojë në të mirë të shoqërisë dhe qytetarëve në tërësi.



Për të arritur një transparencë më të madhe, përveç publicitetit të seancave dhe përditësimit të rregullt të faqes së internetit të KGJRMV-së, është i nevojshëm edhe informimi proaktiv i publikut për çështje që janë jashtëzakonisht të rëndësishme për sigurimin e pavarësisë së këtij institucioni. Për këtë qëllim, krahas masave formale mbrojtëse, është e nevojshme që Këshilli Gjyqësor të afrojë punën e tij me publikun, por edhe me gjyqtarët, me qëllim bashkëpunimin dhe besimin reciprok.



Këshilli Gjyqësor duhet të punojë në përmirësimin e funksionimit të brendshëm të organit. Komunikimi i brendshëm ndërmjet anëtarëve dhe punonjësve është veçanërisht i rëndësishëm dhe do të kontribuojë në një diskutim më konstruktiv dhe në efikasitet dhe efektivitet më të madh të punës së Këshillit Gjyqësor.



Me Ligjin e ri për KGJRMV-në, është krijuar një bazë e mirë për sigurimin e transparencës së Këshillit Gjyqësor. Në të njëjtën kohë, Këshilli Gjyqësor ka vendosur procedura formale dhe strategji komunikimi që duhen zbatuar siç duhet, duke respektuar parimet e profesionalizmit, shpejtësisë, konstruktivitetit, përkushtimit, të cilat janë një nga mënyrat për të rikthyer besimin tek gjyqësori.

